

MOTI

sot



nesër



free press / qytetëse

agon

Mars

14



Website: www.gazeta-agon.com

E-mail: redaksia@gazeta-agon.com, reklama@gazeta-agon.com

ENERGJI

Rritje e naftës në bursa, çmimi arrin 48 dollarë për fuçi



Çmimi i naftës ka pësuar një rritje të ndjeshme në tregjet financiare ndërkombëtare. Ari i zi ka kapur në bursën e Nju Jorkut kuotën e 47.9 dollarëve për fuçi, duke shënuar një rritje prej 92 cent, ekuivalente me 2 për qind kundrejt një dite më parë...

faqe 8

BOTA

Kriza po shkatërron Europën Lindore



Të dhënat e janarit mbi deficitin buxhetor të Bullgarisë dhe Rumanisë duke treguar pikën e dobët ekonomike të dy vendeve Ballkanike, por edhe duke ngritur shqetësime për recesionin që kanë përpara. Deficitit i madh...

faqe 7

LAJMI NË THELLËSI

Eksponentë të medias, autorë në një grusht shteti



Ka dështuar sërish në Gjykatën e Shkallës së Parë në Tiranë seanca gjyqësore për ngjarjen e 14 Shtatorit të vitit 1998 në Tiranë, maratona e të cilave ka nisur mbi 10 vjet më parë. Seanca e së premtes nuk u zhvillua për shkak të mungesës së prokurorit të çështjes dhe një prej përfaqësuesve...

faqe 2

SHKËMBIMET TREGTARE

Shqipëri-Serbi, 90 milionë euro në vit



Dje në Tiranë

Doni të eksploroni Nju Jorkun për 48 orë? Ka plot gjëra për të shijuar në Big Apple (siç quhet ndryshe ai) pa e vrarë xhepin. Me gjithë krizën ekonomike, në qytet mund të bësh pazare të mira.

E premtë

Ora 18.00 - Hyni në dritat verbuese të sheshit Times Square me reklamën e famshme dhe turistët e hutuar, dhe ndoshta mund të gjeni dhe Kauboj-in e Zhveshur, që luan melodi për publikun vetëm me të mbathura, kapele e çizme.

Në se doni të shikoni një shfaqje, blini biletë me çmim të ulur për teatrin Broadway të po kësaj dite, në kabinat

48 orë në Nju Jork



TKTS në sheshin Duffy Square.

Ora 19.00 - Për një pamje më të mirë të Times Square hipni në majë të shkallëve të kuqe prej

xhami pranë kabinave të biletave. Shikoni sesi vazhdon jeta duke ngrenë darkën përpara teatrit, të shitësit e kebabëve ose në restorantet e shumtë të zonës.

23.30 - Zbrisni në qytet dhe shijoni ngrohtësinë dhe intimitetin e klubit të xhazit Arthur's Tavern, në Greenwich Village, nr. 57 Grove street.

E shtunë

Ora 9 - Gosti në mëngjesoren autentike NjuJorkeze të Eisenbergs Sandwich Shop në nr. 174 Fifth Avenue. Zini një karrige në banak, dhe merrni një sanduiç me vezë e majonezë, ose një nga klasikët e tjerë të fast-food-it.

ORA 10 - Shëtisni përgjatë sheshit Union Square deri te tregu i fermerëve me prodhime organike. Merrni byreçka të freskëta me mollë...

faqe 12

FAKTI I DITËS

Kush shkon sot në Bugjon?

Frrok Çupi

Me siguri jam i vonuar me lajmin. Para se të dalë gazeta, gjatë natës do të jetë bërë radhë e gjatë politikanësh për të shkuar në Bugjon. Lexuesi mund të mos e dijë ç'është Bugjoni, por politikanët e dinë që mbrëmë e këndej. Më parë, këta kanë qenë të paditur, natyrisht.

Bugjoni është një fshat shumë i thellë në Pukën e largët. Ata që shkonin në Bugjon gjatë periudhës ateiste të socializmit, ktheheshin në Tiranë me një humor të rrezikshëm: "Takova zotin", thonin, si për të dëshmuar sa afër qiellit bie ky fshat. Dje, një televizion i fryrë nga socialistët e Tiranës, transmetoi një kronikë prej fshatit ku edhe mjegulla kthehet në akull. Televizioni kishte zbuluar se atje njerëzit ishin të varfër; edhe rruga e dikurshme u ishte prishur. Dy a tre fshatarë dolën para kamerave dhe folën me porosi: "Nuk do të votojmë. Ose po të votojmë, votat tona janë për atë që do të na ndërtojë rrugën 5 kilometra". Televizioni, që tashmë përdoret si avangardë politike, ishte udhëzuar mirë nga shefat. Sot, me siguri, do të nisë karvani i politikanëve për të marrë votat e Bugjonit.

Gjithë Shqipëria ka hapur këtë "tendër" politik. Në të gjithë vendin ka fshatra të humbur dhe rrugë të prishura; ka të varfër dhe dembelë; ka edhe njerëz që akoma mund të mashtrohen. Këta përbëjnë lëndën e parë të një politike që po tenton të marrë pushtet me rastin e zgjedhjeve parlamentare të Qershorit...

Vijon në faqen 2

Ekonomi	Euro	Dollar
	130.8 131.3	101.5 102.0

BANKAVE
BSH, RREGULLORE TË RE PËR LICENCIMIN E BANKAVE
 Banka e Shqipërisë ka miratuar një rregullore të re për licencimin e bankave. Sipas burimeve nga BSH-ja, rregullorja e re është një nga risitë e rëndësishme, që ndërmerren nga institucioni qendror bankar në vend për procesin e riorganizimit të bankës. Rregullorja, që ka në fokus marrëdhëniet e bankave mëmë me degët e tyre, nuk është e vetmja që miratohet, në një kohë që tregjet në të gjithë botën po përballen me krizën.

Kryetarët e Dhomave të Tregtisë së të dy vendeve i bëjnë thirrje politikës që të ndjekë shembullin e biznesit dhe të krijojë klimën e përshtatshme për të rritur shkëmbimet tregtare mes Shqipërisë dhe Serbisë

Shkëmbimet me Serbinë, sa gjysma e ish-Jugosllavisë



Aurela Sulçe
Biznesi shqiptar dhe ai serb do të bashkëpunojnë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, duke u përqendruar kryesisht te energjëtika. Drejtuesit e Dhomave të Tregtisë së të dy vendeve janë takuar për të diskutuar lidhur me mundësitë e bashkëpunimit, i cili mbetet në nivele të ulëta dhe larg mundësive reale. "Ekzistojnë mundësitë që bashkëpunimi të rritet dhe të reflektohet në disa mënyra. Interesi i biznesit nga të dy vendet është shumë i lartë dhe ne duhet të shfrytëzojmë vendndodhjen gjeografike.", ka deklaruar Milos Buralin, kryetari i Dhomës serbe të

Tregtisë. Shkëmbimet tregtare mes dy vendeve llogariten në rreth 90 milionë dollarë në vit, një nivel shumë i ulët ky, krahasuar me tregtinë që ne zhvillojmë me vendet e tjera të rajonit. Sipas palës serbe, ekzistojnë të gjitha mundësitë që fluksi i import-eksportit të mallrave mes Serbisë dhe Shqipërisë të arrijë deri në 200 milionë dollarë në vit, aq sa kanë qenë shkëmbimet tregtare që vendi ynë zhvillonte me ish-Jugosllavinë. Për të intensifikuar bashkëpunimin mes kompanive, më datë 24 Mars në Beograd do të zhvillohet forumi i parë i biznesit shqiptari-serb.

Biznesi, apel qeverisë për bashkëpunim
 Intensifikimi i bash-

këpunimit ekonomik Shqipëri-Serbi do të kërkojnë edhe një terren të përshtatshëm politik. Përfaqësuesit e biznesit së të dy vendeve u kanë kërkuar qeverive respektive që të vihen në funksion të sipërmarrjes private. Aktualisht, marrëdhëniet politike Shqipëri-Serbi mbeten prapa atyre ekonomike. "Biznesi ecën një hap para politikës. Është detyra jonë që të krijojmë kontakte mes biznesit për të zhvilluar ambientin tregtar. Por politika do të mundësojë një klimë më të mirë, pasi politika është në funksion të biznesit dhe jo biznesi në funksion të politikës.", ka deklaruar Buralin. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe kryetari i Dhomës sonë së Tregtisë dhe Industrisë, Gjok Ul-dedaj. "Unë mendoj se edhe politika duhet të nd-

jekë këtë frymë. Nuk shohim pengesë nga politika në bashkëpunimin tonë. Politika duhet të ndjekë biznesin në këtë hap, me qëllim që biznesi të hedhë hapin tjetër.", është shprehur Ul-dedaj.

Bashkëpunimi, reagim i përbashkët ndaj krizës
 Bashkëpunimi rajonal është vlerësuar nga përfaqësuesit e biznesit shqiptar dhe serb si mënyra më e mirë për të përballur efektet e krizës ekonomike globale. Kryetari i Dhomës së Tregtisë të Serbisë, Milosh Buralin, theksoi se kriza nuk ka falur asnjë shtet, kështu që edhe Ballkani është i përfshirë nga kjo. Në krizë janë edhe kërkesa, edhe prodhimi, edhe financat. Pra, këto probleme i kemi pasur dhe

i kemi, ndërsa kriza vetëm sa i ka zbuluar më shpejt. "Është e rëndësishme që vendet e rajonit të bashkëprojnë në realizimin e projekteve të përbashkëta, që ta kalojmë sa më lehtë këtë kohë krize. Sigurisht, kemi mundësi ta përballojmë nëse ndërveprojmë në mënyrë rajonale.", ka deklaruar Buralin. Kryetari i Dhomës së Tregtisë

të Tiranës, Gjok Ul-dedaj, tha se është fjala për një treg ku aktorët plotësojnë njëri-tjetrin. "Po t'u referohemi shifrave, edhe Shqipëria, edhe Serbia kanë të njëjtat përqindje të marrëdhënive me KE-në. Ajo çfarë duhet të bëjmë, është intensifikimi i shkëmbimeve tregtare me njëri-tjetrin.", - shtoi Ul-dedaj.

Banka ndërhyt në treg, euro pëson rënie

Banka e Shqipërisë ndërhyt në tregun e këmbimit për të frenuar zhvlerësimin e monedhës kombëtare, lekut. Drejtuesit e agjencive valutore bëjnë të ditur se sot banka ka shitur një sasi të konsiderueshme valute, me qëllim shtimin e saj në qarkullim. Ky veprim synon të ekuilibrojë

deri diku kërkesë-ofertën në tregun e këmbimit dhe të balancojë vlerën e monedhave. Si pasojë, euro ka pësuar një rënie prej 0.5 lekë kundrejt ditës së djeshme. Rënie ka pësuar edhe dollari, si pasojë e kursit së bursave ndërkombëtare. Në këto të fundit, euro është forcuar duke u këmbëruar me 1 dollarë e 29



cent. Ndërkohë në agjencitë e këmbimit, monedha amerikane blihet me 101.5 lekë dhe shitet me 102 lekë, ndërsa euro tregtohet me 130.8 lekë në blerje dhe me 131.3 lekë në shitje. Agjentët në tregun e këmbimit shpjegojnë se gjatë ditëve të ardhshme pritet një rënie e mëtejshme e euros, pikërisht për shkak të ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë. Gjatë muajve të fundit, leku është zhvlerësuar ndjeshëm kundrejt valutave. Një situatë që ka rënduar të gjithë qytetarët që kanë kredi në valutë, të cilët po paguajnë më shumë për interesat mujore. Nga ana tjetër, efektet po i vuajnë edhe konsumatorët, të cilët po përballen me rritje të çmimeve në treg, si pasojë e shtrenjimit të importeve.

cdo dege vërtetimit/konfirmimit për emër, atësi, mbiemër dhe nr e logarisë në formë të shkruar. Me përcjelljen e këtij informacioni nga dega e thesarit në Ministrinë e Financave, kjo e fundit do të procedojë pagesat për në logaritë e përfutuesve. Bankat e autorizuara për çeljen e këtyre llogarive janë: Alpha Bank, Raiffeisen Bank, Banka Popullore, Banka Kombëtare Greke, BKT, Tirana Bank, Union Bank, Banka Ndërkombëtare Tregtare.", - theksohet në njoftimin për shtyp të Ministrisë së Financave.

Financat, kredi 40 milionë euro për rrugët dytësore

Shqipëria merr 40 milionë euro kredi për financimin e rrugëve dytësore. Kredia është dhënë nga Banka e Këshillit të Europës për Zhvillim (CEB). Burime zyrtare në Ministrinë e Financave bëjnë të ditur se një delegacion nga ky dikaster, i kryesuar nga zv.ministri Sherefedin Shehu, negocioi me Bankën për financimin e projektit të rrugëve dytësore në Shqipëri.

"Pas negociatave dy ditore, CEB-i ka rënë dakord të financojë 40 milionë euro, ose 51 milionë dollarë. Në këtë mënyrë projekti bëhet efektiv menjëherë dhe do të fillojë procedurat e tenderimit.", -

bëjnë të ditur burimet e Ministrisë së Financave. Financimi i Bankës së Këshillit të Europës për Zhvillim prej 40 milionë euro është me kushte shumë të favorshme dhe i bashkohet financimeve të akorduara nga IDA, Fondi OPEC dhe IPA. Në total, për këtë projekt sigurohet një shumë prej rreth 96.4 milionë dollarë. Ndërkohë do të vijojnë negociatat dhe me institucione të tjera për të siguruar financimin e nevojshëm. Projekti i rrugëve dytësore ka një vlerë prej rreth 400 milionë dollarë dhe financim do të përdoren për rrugë me ndikim të madh në zhvillimin ekonomik të zonave rurale.

Nis dëmshpërblimi i ish-të përndjekurve

Nis procesi i dëmshpërblimit të ish-të përndjekurve politikë. Ministria e Financave njofton se ka dërguar pranë Bankës së Shqipërisë shkresën zyrtare për kalimin e parave në llogari të 60 ish të dënuarve të parë, që kanë plotësuar dokumentacionin e kërkuar.

"Pas publikimit të listës me rreth 1400 ish të përndjekur që u verifikuan nga ministritë e linjës, Ministria e Financave bëri publike në

media se ishin autorizuar 8 banka të nivelit të dytë, ku ish të përndjekurit e listës zyrtare do të mund të hapnin llogaritë depozite për të marrë dëmshpërblimin.

Deri më tani, rreth 60 shtetas shqiptarë kanë përbushur këtë detyrim, i cili është pasuar me çeljen e fondit nga ana e Ministrisë së Financave.", - theksohet në njoftimin për shtyp. Sipas këtij dikasteri, ish-të përndjekurit që do të për-

fitojnë dëmshpërblimin, duhet të hapin një llogari bankare në një nga tetë bankat e autorizuara nga ministria. Burime zyrtare në këtë dikaster shpjegojnë se shuma që do të përfitojnë ish-të përndjekurit politikë, varet nga vitet e burgut që ata kanë bërë, ndërkohë që në total për dëmshpërblimin e tyre është parashikuar një fond prej 2.2 miliardë lekësh. Me hapjen e logarisë, personat do të depozitojnë fizikisht në degët e thesarit të

Ministria: Bashkia, shkresa për privatizimin e terreneve te Bregu dhe Lumit

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës ka reaguar ndaj akuzave të opozitës se Bashkia e Tiranës po pengohet që të ndërtojë një shkollë për komunitetin e banorëve në Bregun e Lumit. Zv. ministri Enno Bozdo ka deklaruar se pretendimet nuk janë të vërteta, pasi pushteti vendor kishte dhënë miratimin për privatizimin e uzinës Dinamo.

"Dua të ofroj provat e pakundërshueshme që vërtetojnë se Rama ka dhënë pëlqimin e tij për privatizimin e

uzinës dhe se ndërsa bënte këtë gjë, as që i shkente ndërmend interesat dhe nevoja që banorët e Bregut të Lumit kishin për një shkollë për fëmijët e tyre. Në dy shkresat e ardhura nga Bashkia e Tiranës në Prill dhe nëntor 2008, Rama aprovon fillimin e procesit të privatizimit për terrenet e Bregut të Lumit, edhe pse e dinte mirë që banorëve u duhej një shkollë për fëmijët.", - ka deklaruar Bozdo. Sipas tij, kryebashkiaku Rama po mundohet të nxjerrë kapital politik nga kjo histori.